



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 qershor 2024  
Nr. ref.: RK 2443/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI252/23

Parashtrues

**Liridona Nuza**

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 201/2023, të 29 qershorit  
2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar përmes postës nga Liridona Nuza, nga fshati Smolicë, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 201/2023, të 29 qershorit 2023, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), Ac. nr. 8969/22, të 3 marsit 2023 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Deçan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), C. nr. 61/2022, të 9 nëntorit 2022.
3. Aktgjykimin e kontestuar [Rev. nr. 201/2023], të Gjykatës Supreme të 29 qershorit 2023, përfaqësuesi i parashtrueses e ka pranuar më 18 korrik 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekti i kësaj çështjeje është vlerësimi i kushtetutshmërisë i aktgjykimeve [Rev. nr. 201/2023], të 29 qershorit 2023, nga Gjykata Supreme [Ac. nr. 8969/22], të 3 marsit 2023, nga Gjykata e Apelit dhe [C. nr. 61/2022], të 9 nëntorit 2022, nga Gjykata Themelore. Përmes këtyre aktgjykimeve pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses së kërkesës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe neni 9, paragrafi 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve.
5. Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar që identiteti i saj të mos zbulohet “*meqenëse kemi të bëjmë me çështje familjare*”.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 6 nëntor 2023, parashtruesja e kërkesës dërgoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 20 nëntor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që në pajtim me rregullin 25 (1) të Rregullores së punës së Gjykatës t’ia dorëzojë formularin e plotësuar të kërkesës individuale në Gjykatën Kushtetuese, si dokument shtesë të kërkesës që ajo kishte dërguar në gjykatë.
9. Më 20 nëntor 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga kjo Gjykatë që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të shkresës të dërgoj fletëkthesën ku dëshmohet se kur e ka pranuar parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin [Rev. nr. 201/2023] të Gjykatës Supreme të 29 qershorit 2023.
10. Po më 20 nëntor 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.

11. Më 22 nëntor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KI252/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues, si dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI252/23] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi – Peci dhe Enver Peci, anëtarë.
12. Më 27 nëntor 2023, Gjykata Themelore e dorëzoi fletë kthesën në të cilën dëshmohej dita se kur përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar [Rev. nr. 201/2023] të Gjykatës Supreme.
13. Më 15 dhjetor 2023, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës të kërkuar nga gjykata.
14. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
15. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës, ndërsa më 13 maj 2024 Gjykata në përbërje të plotë, me shumicë votash, refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për mos zbulim të identitetit.

### **Përmbledhja e fakteve të rastit**

16. Parashtruesja e kërkesës dhe V. B. kanë lidhur martesë në vitin 2016, nga e cila kanë dy fëmijë, përkatësisht T. B. e lindur në vitin 2015 dhe T. B. i lindur në vitin 2019.
17. Më 27 shtator 2019, bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan për zgjidhje të martesës.
18. Paditësi në padi ka deklaruar se me parashtruesen e kërkesës kanë lidhur bashkësi faktike martesore që nga viti 2013, ndërsa me 20 prill 2016, ata kanë lidhur kurorë pranë Zyrës së Gjendjes Civile në fshatin Drenoc-Deçan.
19. Më 9 gusht 2020, parashtruesja e kërkesës ka parashtruar kundërpadi, që fëmijët t'i besohen asaj, përfshirë edhe kontributin financiar për mbajtjen e fëmijëve.
20. Më 9 nëntor 2022, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 61/2022], aprovoi si pjesërisht të bazuar padinë e paditësit dhe në pikën II të dispozitivit vendosi që të zgjidhet martesë në mes të V. B. dhe parashtrueses së kërkesës.
21. Në pikën III, IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë përcaktoi që: Fëmijët e përbashkët të lindur gjatë bashkësisë martesore të miturit T. B. e lindur më 9 janar 2015 dhe T. B. i lindur më 4 janar 2019 i besohet për mbajtje, kujdes dhe edukim të paditurës, nënës Liridona (Shefqet Nuza) Binakaj, me vendbanim në fshatin Smolicë, komuna e Gjakovës, sikurse që përcaktoi edhe detyrimet financiare për mbajtje të fëmijëve për paditësin V.B. si dhe mënyrën edhe kohën e kontaktit të fëmijëve me babanë e tyre në formën sikurse u përcaktua në aktgjykim.
22. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë brenda afatit ligjor të paraparë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 61/2022] të 9 nëntorit 2022, në Gjykatën e Apelit, pjesërisht në pikat; (i) (V) të dispozitivit, lidhur me kontaktin e fëmijëve me babanë, por vetëm sa i përket kohëzgjatjes së qëndrimit gjatë pushimeve verore, (ii) për kohën e marrjes e fëmijëve në QPS në Gjakovë, (iii) lidhur me vendimin ku babai do t'i marrë fëmijët dy herë në muaj, (iv) pikën (VII) të dispozitivit, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerë prej 796.00 euro, të cilat parashihej t'i bartë ajo vetë.

23. Përgjigje në ankesë, ka parashtruar edhe i padituri, përmes përfaqësueses së tij, duke kundërshtuar pretendimet ankimore të parashtrueses së kërkesës, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.
24. Më 3 mars 2023, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 61/2022], i 9 nëntorit 2022, nxori Aktgjykimin Ac. nr. 8969/22.
25. Në aktgjykim Gjykata e Apelit vendosi: “(i). Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e parashtruesit të kërkesës. Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore, datë 09 nëntor 2022, pjesërisht në pikën (V) të dispozitivit, lidhur me kontaktin e fëmijëve me babanë vetëm në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit gjatë pushimeve verore dhe kohën e marrjes së fëmijëve në QPS në Gjakovë. Gjykohet se: Caktohet kontakti i babait V.B me fëmijët e tij të mitur T.B dhe T.B që të qëndrojnë tek babai për pushime verore për 15 ditë në shtëpinë e tij, ndërsa marrja e fëmijëve në QPS në Gjakovë nga babai do të bëhet në orën 16:00. Ankesa për pjesën tjetër të pikës (V) të dispozitivit refuzohet pjesërisht dhe aktgjykimi i atakuar në pjesën tjetër të pikës (V) të dispozitivit vërtetohet. (ii) Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e parashtruesit të kërkesës në pikën (VII) të dispozitivit, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore. Gjykohet se: Secila palë do të bartë shpenzimet e veta procedurale. (iii) Pikat (I), (II), (III), (IV) dhe (VI) e aktgjykimit të atakuar mbeten të pashqyrtuara”.
26. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 8969/2022], të 3 marsit 2023, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur revizionin, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të të drejtës materiale.
27. Më 29 qershor 2023, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 201/2023], me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 8969/2022], të 3 marsit 2023.
28. Në arsyetimin e Aktgjykimit [Rev. nr. 201/2023], Gjykata Supreme ndër të tjera deklaroi:

*“Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:*

*Revizioni i të autorizuarit të parashtrueses së kërkesës, avokat Prenk Pepaj nga Gjakova, është i pabazuar. Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur e ka aprovuar pjesërisht ankesën e të paditurës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën e kohëzgjatjes së kontaktit gjatë pushimeve të verës nga 30 ditë në 15 ditë.*

*Pretendimet e revizionit lidhen vetëm me çështjen që ka të bëjë me kontaktet e fëmijës dhe nuk veçojnë ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, përveç pretendimeve të nenit 182.2 nënpika n) e LPK-së. Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragraf 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë i është përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të*

*gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

29. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e parashtruar pretendon se Gjykata Supreme, ka nxjerrë aktgjykimin e kontestuar, [Rev. nr. 201/2023] në duke bërë shkelje të të drejtave të parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe neni 9, paragrafi 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve. Parashtruesja e kërkesës ka potencuar në kërkesë se janë shkelur dispozitat e ligjit për familjen dhe të LPK-së, por pa përcaktuar nene të veçanta të këtyre ligjeve që supozohet se i janë shkelur.
30. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e paraqitur në gjykatë pretendon: *“sa i përket mënyrës së kontaktit të fëmijëve të përbashkët me babain, janë kundërligjor, meqenëse të njëjtat aktgjykime janë marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për familjen të Kosovës dhe dispozitat e LPK-ë si dhe nenin 9, paragrafi 3 të Konventës mbi të drejtat e fëmijës, të datës 20 nëntor 1989 e zbatueshme në Kosovë, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, meqenëse nuk e kemi kundërshtuar kontaktin e paditësit me fëmijët e mitur të përbashkët, por mënyrën e kontaktit”.*
31. Pretendimet e parashtrueses së kërkesës kryesisht kanë emërues të përbashkët që gjykatat e rregullta përcaktuan mënyrën e kontaktit të fëmijëve me babanë e tyre pa konsultimin me psikologë e që kjo sipas parashtrueses shkel të drejtat e fëmijëve.

### **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

#### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

##### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

*“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

*2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*

*3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”.*

##### **Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.”

## KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 6

#### (E drejta për një proces të rregullt)

“1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2.Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.

## KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

### Neni 9

[...]

“3. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të

*drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës”.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

34. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

#### **Neni 47 (Kërkesa individuale)**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

#### **Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)**

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

#### **Neni 49 (Afatit)**

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”*

35. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:



*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

36. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesja kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin [Rev. nr. 201/2023], të 29 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me dy aktgjykimet e shkallëve më të ulëta gjyqësore, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës, po ashtu kryesisht i ka sqaruar pretendimet e saj për të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur, ashtu siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
37. Në dritën e fakteve dhe argumenteve të paraqitura me këtë kërkesë, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses ngre çështje kushtetuese, të cilat kërkojnë shqyrtim të meritave të kërkesës, andaj në raport me si më sipër, në vijim, Gjykata do të trajtojë meritat e rastit për të përcaktuar nëse kërkesa dhe pretendimet e ngritura janë brenda ose jo kuadrit të përcaktuar me kriteret e rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.
38. Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës së parashtruar nga parashtruesja e kërkesës konsiston kontestimin e vendimeve gjyqësore që përcaktuan mënyrën dhe kohe gjatjen e kontaktit të fëmijëve mbi të cilët asaj iu caktua kujdestaria me babain e tyre.
39. Lidhur me si më sipër, Gjykata vë në pah se përkitazi me të drejtën e fëmijëve për mbajtjen e kontakteve me prindërit Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në praktikën e saj gjyqësore ka konfirmuar se "Gëzimi i ndërsjellë i shoqërisë se njeri-tjetrit nga fëmija dhe prindërit përbën një element thelbësor të jetës familjare" ( shih rasti [Levin kunder Suedisë](#), Aktgjykim i GJEDNJ, i 15 mars 2012, parag. 57, shih gjithashtu rastin e gjykatës [K166/12](#) ,parashtrues Luljeta Aliu Aktvendim për Papranueshmëri i 22 majit 2023 par 19.
40. Gjykata më tej vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se në thelb me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 201/2023] të 29 qershorit 2023, specifikisht i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 9, paragrafi 3 të Konventës për Drejtat e Fëmijëve, sikurse dhe dispozitat e Ligjit për familjen dhe të LPK-së po pa përcaktuar se cilat janë ato dispozita konkrete që supozohet se janë shkelur.

#### **Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës**

41. Sa i përket pretendimit të parashtrueses të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, ose status, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [K1157/18](#), parashtrues Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33, dhe [K1217/19](#), parashtrues *Astrit Shabiu*. Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2021, paragrafi 6, shih po ashtu, rastet e GJEDNJ-së [Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës](#), kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976,



paragrafi 56; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 61). Sipas këtyre praktikave gjyqësore, jo çdo dallim në trajtim do të jetë diskriminues, por vetëm nëse i mungon justifikimi objektiv dhe i arsyeshëm, gjegjësisht nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse i mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2016, dhe referencat e tjera të përmendura aty).

42. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih, rastet e Gjykatës *KI163/18*, parashtrues *Kujtim Lleshi*, paragrafi 85, dhe *KI124/20* parashtrues *Muhamed Ali Ceys Ulmedine*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42) dhe *KI221/21*, parashtrues *Shpejtim Gacaferri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2022, par 55.
43. Prandaj, Gjykata në vlerësimin e fakteve dhe provave të këtij rasti gjen se parashtruesja e kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e saj se si ajo është trajtuar ndryshe nga persona të tjerë në situata të ngjashme dhe, rrjedhimisht, nuk ka mbështetur pretendimin e saj për diskriminim apo pabarazi në procedurë para gjykatave të rregullta.

#### **Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së**

44. Për sa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me nenin 31 të Kushtetutës, lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se argumenti kryesor i parashtrueses së kërkesës është se vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta, janë “*janë kundërligjor, meqenëse të njëjtat aktgjykime janë marrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit për familjen të Kosovës dhe depozitat e LPK-ë si dhe nenin 9, paragrafi 3 të Konventës mbi të drejtat e fëmijës, të datës 20 nëntorit 1989*” dhe kjo sa i përket përcaktimit të mënyrës së kontaktit të babait me fëmijët pas divorcit në mes të dy prindërve.
45. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht thekson se, si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe, si të tilla, parimisht, nuk janë çështje të Gjykatës Kushtetuese (shih rastet nr. *KI06/17*, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; *KI75/17*, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55; dhe *KI122/16*, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
46. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me mënyrën se si gjykatat e rregullta bëjnë konstatimin e fakteve ose interpretimin e ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato (gjykatat e rregullta) mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë arsyet faktike dhe ligjore që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim, në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata Kushtetuese do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Pra, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: *KI70/11*, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; *KI06/17*, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe *KI122/16*, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

47. Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e cituar më lart, KI75/17, paragrafi 59).
48. Prandaj, duke u bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet e parashtrueses së kërkesës për kundërligjshmërinë e vendimeve gjyqësore ngrenë në çështje të shkeljeve kushtetuese.
49. Në këtë vazhdë, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në mënyrë specifike konteston pjesën e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, përmes së cilave ishte përcaktuar mënyra e kontaktit me dy fëmijët me babanë e tyre pas zgjedhjes së martesës në mes të parashtrueses së kërkesës dhe bashkëshortit të saj.
50. Duke iu referuar procedurave të zhvilluara në rastin konkret dhe specifikuat objektit të kontestimit, Gjykata vë në dukje se Gjykata Themelore në Pejë – dega në Deçan me Aktgjykimin [C. nr. 61/2022] të 9 nëntorit 2022 kishte aprovuar pjesërisht padinë e paraqitur nga V. B. për zgjidhje të martesës me parashtruesen, kishte vendosur që të dy fëmijët e tyre të lindur gjatë martesës së përbashkët *“t’i besohet për mbajtje, kujdes dhe edukim të paditurës nënës”* - parashtrueses së kërkesës.
51. Sa i përket çështjes së kontaktit të fëmijëve me babanë e tyre Gjykata Themelore kishte vendosur: *“Gjatë pushimeve Dimërore paditësi t’i merr fëmijët 5 ditë në shtëpinë e tij, ndërsa gjatë pushimeve verore 30 ditë si dhe ditën e dytë të festave shtetërore, kombëtare, familjare dhe fetare sipas marrëveshjes të paditësit me të paditurën që ky kontakti të kryhet përmes Qendrës për punë Sociale në Gjakovë”*.
52. Gjykata vëren se vendimi për mënyrën dhe kohën e kontaktit të fëmijëve të parashtrueses me babanë e tyre – paditësin V. B. si në pikën V të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte marrë duke marrë parasysh deklaratimet e palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor dhe mendimin e ekspertit të QPS-së.
53. Nga të dhënat e deponuara në kërkesën e parashtrueses konstatohet se parashtruesja e kërkesës në afat ligjor kishte bërë ankesë në Gjykatën e Apelit pikërisht për mënyrën dhe kohën e përcaktuar për kontakt në mes të fëmijëve dhe babait, pas zgjedhjes së martesës në mes të prindërve të tyre.
54. Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesën e parashtrueses së kërkesës, me Aktgjykimin [Ac. nr. 8969/22] të 3 marsit 2023 kishte vendosur që ta aprovojë pjesërisht ankesën e paraqitur dhe kishte ndryshuar pikën (V) të dispozitivit, lidhur me kontaktin e fëmijëve me babanë vetëm sa i përket kohëzgjatjes së qëndrimit gjatë pushimeve verore, si dhe për kohën e marrjes së fëmijëve në QPS në Gjakovë, ashtu që gjykohet: CAKTOHET kontakti i babait V. B. me fëmijët e tij të mitur T. B. dhe T. B. që të qëndrojnë tek babai për pushime verore 15 ditë në shtëpinë e tij, si dhe marrja e fëmijëve në QPS në Gjakovë nga babai V. B. të bëhet në orën 16:00. Gjykata e Apelit kishte vendosur gjithashtu që pjesa tjetër e aktgjykimit të ankimuar të mbetet e pa ndryshuar dhe si e tillë është vërtetuar.
55. Gjykata e Apelit, në aktgjykimin e saj, ndryshimin e kohëzgjatjes së kontaktit të fëmijëve me babanë në kohën e pushimeve verore nga 30 ditë në kohëzgjatje prej 15 ditësh e arsyetoi: *“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi i fëmijëve për 30 ditë gjatë pushimeve verore tek babai i tyre është periudhë shumë e gjatë, veçanërisht kur fëmijët janë në moshën e vogël, vajza e lindur në vitin 2015 dhe djali i lindur në vitin 2019. Kjo periudhë mund të ndikojë në zhvillimin emocional të tyre, sidomos për*

*djalin i cili është vetëm 4 vjeç dhe do të qëndrojë pa nënën për 30 ditë gjatë pushimeve verore”.*

56. Gjykata më tej arsyetoi: *“Gjykata vlerësoi se lidhja emocionale e fëmijëve me nënën e tyre është e fortë. Duke u nisur nga interesat më të mira të fëmijëve dhe duke mbështetur vlerësimin e fundit të Qendrës për Përkrahje Sociale (QPS) nga data 14 prill 2022, në Gjakovë, gjykata konstatoi se fëmijët janë të lidhur emocionalisht më shumë me nënën e tyre. Psikologu-menaxher i rastit në raportin e QPS konfirmoi se fëmijët janë të lidhur emocionalisht më shumë me nënën e tyre, pasi që prej momentit të ndarjes kanë jetuar me nënën nën përkujdesjen e saj, e që ka ndikuar që lidhja e tyre emocionale me nënën të forcohet edhe më shumë. [...] Për këto arsye, Gjykata e Apelit ka ndryshuar pjesën e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit të fëmijëve tek babai gjatë pushimeve verore, duke e reduktuar atë në 15 ditë. Ky vendim ka për qëllim të sigurojë një periudhë më të shkurtër qëndrimi tek babai, duke respektuar në të njëjtën kohë interesin më të mirë të fëmijëve, siç është garantuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve”.*
57. Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar kishte paraqitur përmes të autorizuarit të saj kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen për sa i përket pikës V të aktgjykimit të shkallës së parë ashtu që siç ka propozuar e paditura, apo që të dy aktgjykimet të prishen dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje për këtë çështje.
58. Gjykata Supreme me Aktgjykimin [Rev. 201/2023], të 29 qershorit 2023 kishte vendosur ta refuzojë si të pabazuar revizionin e paraqitur nga i autorizuari i parashtrueses së kërkesës dhe lidhur me pretendimin lidhur me zbatimin e gabuar ligjit kishte arsyetuar: *“Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur e ka pjesërisht ankesën e të paditurës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën e kohëzgjatjes së kontaktit gjatë pushimeve të verës nga 30 ditë në 15 ditë. Pretendimet e revizionit lidhen vetëm me çështjen që ka të bëjë me kontaktet e fëmijës dhe nuk veçojnë ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore përveç asaj të nenit 182.2 nënpika n) e LPK-së”.*
59. Gjykata Supreme gjithashtu më tej kishte arsyetuar:
- “[...] Referuar pretendimeve në revizion, të cilat kufizohen vetëm në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit për sa i përket kohëzgjatjes së kontakteve të fëmijëve me prindin jo kujdestar, gjatë pushimeve verore ndërsa për pjesët tjera revizioni nuk e atakon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë. Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë i është përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. [...]”*
60. Gjykata Supreme kur kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e paraqitur në raport me çështjen e kontaktit të fëmijëve me babanë e tyre, potencoi faktin që: *“edhe Raporti i fundit i Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë, i datës 14.04.2022, ku psikologja konstaton se fëmijët janë të lidhur emocionalisht më shumë me nënën e tyre, pasi prej momentit të ndarjes kanë jetuar me nënën dhe preferohet qëndrimi prej 15 ditësh”.*

61. Nga të dhënat si më sipër, Gjykata konstaton se vendimet e gjykatave të rregullta ishin të arsyetuara, se parashtruesja personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të saj ishte pjesë aktive gjatë gjithë procesit gjyqësor, që pretendimet e saj ankimore lidhur me cenimin e dispozitave të caktuara ligjore, sikurse i kishte theksuar ajo, gjatë procesit gjyqësor u shqyrtuan në gjykatat kompetente dhe gjykatat e rregullta dhanë përgjigjeje në ato pretendime të ngritura nga parashtruesja e kërkesës . Gjykata, në këto rrethana nuk mund të konstatojë se vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta ishin të përfshira me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, andaj në këtë gjendje të konstatuar, gjykata kërkesën duhet të shpallë si qartazi të pabazuar.

### **Përkitazi me shkeljen e pretenduar të nenit 9.3 të Konventës Mbi të Drejtat e Fëmijës**

62. Gjykata vëren se pretendimi thelbësor i parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e kësaj konvente lidhet me marrjen e vendimeve gjyqësore për kontaktin e fëmijëve me babanë e tyre pa mendimin paraprak të psikologut.
63. Thelbi i nenit 9.3 të Konventës për Mbrojtjen e fëmijës, i cili pretendohet të jetë shkelur në dëm të parashtrueses së kërkesës, konsiston në faktin se shteti duhet të respektojë” *Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij*”.
64. Nga vendimet e gjykatave të rregullta që kontestohen para gjykatës vërehet se pikërisht kjo e drejtë e fëmijëve edhe është shqyrtuar edhe vendosur. Çështja se për parashtruesen e kërkesës kjo mënyrë e vendosjes së kontestit dhe rezultati final i aktgjykimeve gjyqësore nuk ishin në përputhje me pritjet dhe interesin e saj nuk bën në vetvete këto vendime gjyqësore jo kushtetuese.
65. Për më tepër, në raport me pretendimin kryesor të parashtrueses së kërkesës për mos përfshirjen e psikologut dhe mendimit të tij/saj në marrjen e vendimeve, Gjykata vlerëson se kur Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 8969/22] të 3 marsit 2023 dhe aprovoi pjesërisht ankesën e parashtrueses së kërkesës pikërisht lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e takimit të fëmijëve me prindin i cili nuk ishte i caktuar për kujdesin prindëror, analizoi gjerësisht faktet e rastit dhe interesin e fëmijëve dhe mori parasysh edhe raportin e QPS të 14 prillit 2022, i cili përmbante edhe mendimin e psikologut, e ku preferohej që kohëzgjatja e kontaktit me babanë gjatë pushimeve verore të jetë 15 ditë, pikërisht sikur edhe vendosi Gjykata e Apelit. Gjykata Supreme i mbështeti këto konstatime dhe nuk gjeti në aktgjykimin e saj për revizion të ketë shkelje ligjore, andaj, në këto rrethana, Gjykata nuk mund të konstatojë se pretendimi i parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e Konventës për Mbrojtjen e Fëmijës (neni 9.3) është i bazuar.

### **Kërkesa për mos zbulim të identitetit të parashtrueses**

66. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkon që identiteti i saj në këtë rast të mos zbulohet.
67. Në raport me këtë kërkesë gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës kërkesën e saj në Gjykatë e kishte dërguar përmes postës dhe në kërkesën fillestare të sajë nuk figuronte fare kërkesa për mbulimin e identitetit të saj;. Në fakt kërkesa ishte paraqitur vetëm kopjen e formularit të kërkesës të kërkuar nga gjykata ku është shënjuar katrori



përkatës dhe me arsyetimin e përmbledhur në fjalinë e vetme “të mos zbulohet sepse kemi të bëjmë me çështje familjare”

68. Në raport me kërkesën si më sipër, Gjykata i referohet Rregullit 24 të Rregullores së punës lidhur me mos zbulimi i identitetit te palëve, i cili rregull përcakton:

*(2) Gjykata vendosë lidhur me kërkesën e palës për moszbulim të identitetit me miratimin e shumicës së gjyqtareve.*

*[...]*

*(4) Në rast të moszbulimit të identitetit, pala identifikohet vetëm me iniciale, shkurtesa ose një (1) shkronjë të vetme.*

69. Në raport me arsyetimin e dhënë nga parashtruesja për moszbulimin e identitetit gjykata konstaton se gjykatat e rregullta në secilin prej aktgjykimeve të tyre parashtrueses i ishin referuar me emrin e plotë të sajë e edhe emrat e fëmijëve janë pasqyruar të plotë në ato vendime. Gjykata duke marrë parasysh karakteristikat e rastit dhe moshën e fëmijëve në rastin konkret identitetin e fëmijëve e ka pasqyruar me inicialet e tyre por nuk gjen arsye që të njëjtën ta aplikojë edhe në rastin e parashtrueses së kërkesës. Andaj, Gjykata nuk gjen arsye që të miratojë kërkesën për moszbulimin e identitetit të parashtruesit të kërkesës (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës, KI74/17 parashtrues *Lorenc Kolgjeraj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 32 dhe (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës, KI74/17 parashtrues *Lorenc Kolgjeraj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 janarit 2018, paragrafi 32 si dhe [Ki 11/20](#) parashtrues Elez Elezi, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 dhjetorit 2020 paragrafi 103.

## **Përfundime**

70. Në fund, pas shqyrtimit të plotë të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, provave të bashkëngjitur me kërkesën, duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, Gjykata konstaton se pretendimet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës për shkelje të nenit 24, 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 9 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës klasifikohen si pretendime të cilat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. Prandaj, kërkesa në tërësi deklarohet e papranueshme si qartësisht e pabazuar në bazë kushtetuese, paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, si dhe në bazë të neneve 47 dhe 48 të Ligjit.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 13 maj 2024:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, kërkesën për mos zbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

  
Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani